



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 120, datë 15.07.2019**

**PËR**  
**VERIFIKIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE LIGJORË PËR REKRUTIMIN SI**  
**GJYQTARE TË KANDIDATES, ZNJ. AMARILDA SULAJ**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 35 në lidhje me nenin 32 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimet e Këshillit nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” dhe nr. 82, datë 05.06.2019 “Për caktimin e relatorit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve për secilin kandidat për gjyqtar të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2018”, në propozimin e relatorit pranë Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Të kualifikojë për emërim, kandidaten Amarilda Sulaj, e diplomuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2017 – 2018 dhe vijimin e procedurës së emërimit të saj si gjyqtare.
2. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet kandidates.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**